



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1408/14 prot.

Datë 24.07.2024

**V E N D I M**

**Nr. 957/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.07.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 867/2024, datë 15.07.2024, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-02682-04-25-2024, me objekt: “Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe impianteve hidrikë për shuarjen e zjarrit”, me fond limit 25,858,120.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 13.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.
- Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Oni” SHPK & “Cara” SHPK, përfaqësuar nga operatori ekonomik “Oni”, me NIPT J66902008N dhe adresë: Lagjja “Vasil Shanto”, Rruga: “Hydajet Lezha”, Nr. 32, Shkodër.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.  
Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Climacasa” SHPK me NIPT L07805502F dhe adresë: Rruga "Shtraus", Pallati Nr. 1, kati

përdhe, Njësia me numër pronësie 5/82-N1, ZK Nr. 863, Lezhë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 15.07.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 867/2024 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Oni” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-02682-04-25-2024, me objekt: “Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe impianteve hidrikë për shuarjen e zjarrit”, me fond limit 25,858,120.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 13.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.*
2. *Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të ndjekë hapat proceduralë që parashikon ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, për trajtimin e ofertës anomalisht të ulët të operatorit ekonomik “Climacasa” ShPK, dhe të rikthejë procedurën vetëm për këtë operator ekonomik, në mënyrë që të kryejë vlerësimin e tij në përputhje me parashikimet e nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Oni” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 2985/1 prot., datë 22.07.2024 protokolluar me tonën nr. 1408/11 prot., datë 24.07.2024 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 867/2024 datë 15.07.2024, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-02682-04-25-2024, me objekt: “Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe impianteve hidrikë për shuarjen e zjarrit”, me fond limit 25,858,120.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 13.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

## II

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton:**

II.1 Me shkresën nr. 2985/1 prot., datë 22.07.2024 protokolluar me tonën nr. 1408/11 prot., datë 24.07.2024 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 867/2024 datë 15.07.2024, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-02682-04-25-2024, me objekt: “Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe impianteve hidrikë për shuarjen e zjarrit”, me fond limit 25,858,120.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 13.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.867/2024 datë 15.07.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësim të procedurës object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.867/2024 datë 15.07.2024 të këtij Komisioni, duke i kërkuar sqarime operatorit ekonomik “Climacasa” SHPK për ofertën anomalisht të ulët

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-02682-04-25-2024, me objekt: “Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe impianteve hidrikë për shuarjen e zjarrit”, me fond limit 25,858,120.00 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 13.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**